VENDIM
Nr. 401, datë 13.5.2015

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS DHE TË RREGULLAVE PËR PAGIMIN E SAJ NË NJË PROCEDURË ANKIMIMI NDAJ PROCEDURAVE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PRANË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ankesa e paraqitur në rrugë elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) nga çdo person që ka ose ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë koncesioni/partneriteti publik privat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, duhet të përmbajë dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse.
2. Përjashtimisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë KKP-së shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse në numrin e llogarisë së KPP-së.
3. Për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, përcaktohet kjo tarifë pagese, e cila është 10% e vlerës së sigurimit të ofertës në rastet kur është kërkuar një sigurim oferte ose 0.2% e vlerës së parashikuar të kontratës koncesionare, që ankimohet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë vlerën e tarifës që kërkohet për shqyrtimin administrativ në dokumentet standarde të koncesionit/ partneritetit publik privat.
4. Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e tij përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja.
5. Pagesa e tarifës i kthehet ankimuesit, kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet.

Kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimimit derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama